



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL. Anr.178/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të vendosjes së posterit në shtylla elektrike, të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndërsa subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 400.00 (katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017 kanë vërejtur se në rrugën “Remzi Ademaj” në Prizren, në vendin e ndaluar publik në trafo elektrike është vendosur poster i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal të Prizrenit, Furkan Erguler nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP). Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik KDTP, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 12.10.2017, subjekti politik KDTP, thekson se pas pranimit të ankesës nr. ZL.Anr.81/2017 kanë ndërmarr masat paraprake për heqjen e posterave, ashtu që me datë 10.10.2017 në momentin e parashtrimit të ankesës nuk i kanë pasur posterët në vendet e lartëcekura në ankesë. Për të mbështetur pretendimet ankimore, ka bashkangjitur disa fotografi të printuara në vendet ku ishte evituar shkelja.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik KDTP është vendosur në trafo elektrike gjegjësisht në hapsira dhe në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*”

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik KDTP, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre për shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimin i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.178/2017 më datën 12.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.